



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 185, Datë 06.07.2026

MBI

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH)" SH.A. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-ET LUNDRUESE "TIGRI 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW DHE "TIGRI 3", ME KAPACITET TË INSTALUAR 60 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma "a", të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma "a", 5, pika 1, gërma "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma "a" të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1950/1 prot., datë 03.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "*Mbi kërkesën e shoqërisë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)" sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 MW dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 MW*",

Konstatoi se:

- Shoqëria "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950 prot., datë 23.06.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et Lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 MW dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 MW, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.
- Nga verifikimi paraprak i aplikimit rezulton se shoqëria ka aktualisht një licencë të vlefshme deri në datën 22.08.2026, dhe ka paraqitur dokumentacionin bazë të kërkuar për fillimin e procedurës administrative dhe gjithashtu, shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të Rregullores, rezulton se aplikimi duhet të plotësohet me dokumentacionin dhe sqarime të mëtejshme, në përputhje me kërkesat e Rregullores së Licencimit, përpara se Bordi të shprehet përfundimisht mbi kërkesën.

Shqyrtimi paraprak i aplikimit

- Në mbështetje të nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, u krye verifikimi paraprak i kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria **"Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)" sh.a.**
- Nga shqyrtimi paraprak rezulton se aplikimi është paraqitur në formatin e kërkuar nga Rregullorja e Licencimit dhe është shoqëruar me dokumentacionin bazë të nevojshëm për fillimin e procedurës administrative.
- Gjatë këtij verifikimi u konstatua se, në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, c dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmës (a).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Rezulton se shoqëria "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)" sh.a.:

- Ka depozituar Kontratën "Bareboat" dhe Marrëveshjen e shërbimeve O & M, me nr. 1660/1 prot., datë 04.04.2022, nënshkruar ndërmjet KESH sh.a., në cilësinë e Kompanisë dhe shoqërive "EXELERATE GLOBAL OPERATIONS" L.L.C, si Pronar i parë dhe "RENCO" S.P.A., si Ofrues i Parë i Shërbimeve, së bashku me Amendamentin 1 me nr. 1660/7 prot., datë 07.04.2022.
- Ka nënshkruar më herët, në datën 17.03.2023, *Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të dy njësive gjeneruese termike (TEC) lundruese, me shoqërinë "Operatori Sistemit Transmetimit" (OST) sh.a.*
- Është pajisur me Lejen për përdorim burimi ujor sipërfaqësor me nr. Serie 000047, nr. 5/7 prot., datë 15.03.2023, të miratuar me Vendimin nr. 3, datë 13.03.2023, të Këshillit të Basenit UjorVjosë.
- Është pajisur me Aktin e Miratimit - Leje Mjedisi Tipi A, me nr. 1665 prot., datë 03.03.2023, me titull *"Industritë Energjitike, Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza", për të zhvilluar projektin ID 1.1 Instalimet me djegie. ID 6.1 Instalim trajtimi për ujëra të ndotura urbane. ID 6.2 Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen. Kapaciteti i projektuar*

është 110 MW”, me vendndodhje Qarku Vlorë, bashkia Vlorë, Njësia Administrative Qendër Vlorë, Nartë, Triport Zona Kadastrale 8604.

Në këtë aplikim shoqëria duhet të depozitojë dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: dëshminë e penalitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: të sqarojë/saktësojë me shoqërinë në lidhje me mbështetjen financiare për sa referuar në plan-biznesin e përgjithshëm dhe programin ekonomik, si dhe të depozitojë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin dokumentet e depozituara në kuadër të kësaj pike.
- **gërma “c”**: të depozitojë Plan-Biznesi i Përgjithshëm të nënshkruar dhe/ose vulosur dhe të plotësojë këtë dokument me të gjitha sqarimet/konkluzionet dhe analizat që kanë të bëjnë me nevojën e operimit të këtij impianti për të gjithë periudhën e kërkuar për operim, si dhe parashikimet përkatëse në lidhje me jetëgjatësinë e licencës.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- **gërma “a”**: të plotësojë jetëgjatësinë e pritshme të centralit, afatin për të cilin kërkon licencimin dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës për jetëgjatësinë e centralit.

gërma “b”: autorizimin e organit shtetëror për ndërtimin/operimin e këtij centrali; të dokumentojë që të gjitha përcaktimet e kontratës janë përmbushur; dhe të informojë/dokumentojë modalitetet mbi bazën e të cilave do të bëhet kalimi i asetit në pronësi.

Po ashtu, duhet të depozitojë amendamentin me nr. 1660/7 prot., datë 07.04.2022 të përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe kontratën në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

- **gërma “c”**: të depozitojë marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.
- **gërma “d”**: të depozitojë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin Lejen e ujit dhe vendimin e KBU Vjosë.
- **gërma “e”**: të depozitojë në ERE Kontratën e Koncesionit nr. rep., 554, nr. Kol 203, datë 29.04.2022, si dhe dokumente të tjera që mund të afektojnë Lejen e Mjedisit apo këtë procedurë.

Po ashtu, vlerësohet që ERE t’i drejtohet dhe vetë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në lidhje me vlefshmërinë dhe zbatimin e kushteve të kësaj lejeje.

Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.

Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-et Llundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW, dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 MW, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.
2. Shoqëria "**Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)**" sh.a., të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit Transmetimit” (OST sh.a.) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrît AHMETI